



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019", Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026, miraton këtë:



V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbëhet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:

- 2.1 Mimoza BAJRAKTARI--AAK--përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 Vlora KRYEZIU-----LDK---përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 Emrush BYTYQI-----përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 Shqipron BYTYQI-----përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 Refki ZOGAJ-----përfaqësues nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ku komisioni lidhur me ankimin vendosi me vendim në këtë mënyrë;

- 3.1 **refuzimin e ankesës** dhe lënia në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertës
- 3.2 **miratimin e ankesës** dhe shfuqizimin, revokimin e procesit të vlerësimit final të ofertës.

Neni 4

4.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë.

4.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 5

5.1 Mandati i anëtareve të Komisionit të ankesave është 2 (dy) vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

5.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 410-9875
Me datë 27.02.2026



Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

